



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.216, datë 29.06.2021

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Z. Neritan Hoxha**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.
2. Z. Neritan Hoxha do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, nga data 01.07.2021 - 30.09.2021.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Neritan Hoxha do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.
4. Të njoftohen për këtë vendim Neritan Hoxha, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ